




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0014451-6/26 dt. 27.03.2026
Mitrovicë



Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, pika d, dhe nenit 17, paragrafi 1, pika k, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008); nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe nenit 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.11 të Statutit të Komunës; nenin 40 paragrafi 3 të Rregullores Komunale nr. 08/2023 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe granteve; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 27.03.2026, pasi shqyrtoi Kërkesën e DMS-së Nr. 02-352/05-0012691/26 dt. 09.03.2026 Për vazhdimin e marrëveshjes me Këshillin e Bashkësisë Islame – Dega në Mitrovicë për ofrimin e shërbimeve të varrimit për qytetarët e Komunës, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-00013479-5/26 dt. 17.03.2026); sjell këtë:

VENDIM

Për autorizim të Kryetarit Komunës për rinegocim dhe arritje të Marrëveshjes me Këshillin e Bashkësisë Islame – Dega në Mitrovicë

1. **AUTORIZOHET** Kryetari i Komunës të rinegociojë dhe të arrijë Marrëveshje me Këshillin e Bashkësisë Islame – Dega në Mitrovicë për vazhdimin e Marrëveshjes Për kryerjen e shërbimeve dhe ceremonive fetare si edhe ekzaminimin e kufomës duke inkuadruar edhe mjekun nga QKMF-ja.
2. Sipas pikës 1 të këtij Autorizimi, Kuvendi i Komunës e obligon Kryetarin që të negociojë Marrëveshjen me Këshillin të Bashkësisë Islame – Dega në Mitrovicë me kohëzgjatje tre vjeçare duke pas parasysh periudhën pas skadimit të kontratës paraprake, periudhë e cila duhet të trajtohet retroaktivisht.
3. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë



Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 MAPL-së
- 1 x 1 Arkivit
- Kopje: Kryetarit të Komunës
Drejtorisë për Mirëqenie Sociale